



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA KUSHTETUESE  
УСТАВНИ СУД  
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 19 janar 2015  
Nr. ref.:RK747/15

## AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

**Rastin Nr. KI116/14**

Parashtrues

**Fadil Selmanaj**

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së  
Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, AA nr. 294/2013,  
të 4 shkurtit 2014**

### GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar  
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar  
Robert Carolan, gjyqtar  
Altay Suroy, gjyqtar  
Almiro Rodrigues, gjyqtar  
Snezhana Botusharova, gjyqtare  
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe  
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

#### **Parashtruesi i kërkesës**

1. Kërkesa është dorëzuar nga z. Fadil Selmanaj (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës) nga Mitrovica.

## **Vendimi i kontestuar**

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, AA. nr. 294/2013, të 4 shkurtit 2014, i cili i ishte dorëzuar atij më 12 mars 2014.

## **Objekti i çështjes**

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktgjykimit të kontestuar të Gjykatës së Apelit të Kosovës.

## **Baza juridike**

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta) dhe në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji).

## **Procedura në Gjykatën Kushtetuese**

5. Më 8 korrik 2014, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 6 gusht 2014, Kryetari i Gjykatës me Vendimin nr. GJR. KI116/14 caktoi gjyqtaren Snezhana Botusharova gjyqtare raportuese. Të njëjtën ditë, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin nr. KSH. KI116/14 caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Almiro Rodrigues dhe Enver Hasani.
7. Më 20 gusht 2014, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës së Apelit të Kosovës.
8. Më 4 shtator 2014, Gjykata e njoftoi Gjykatën Themelore në Prishtinë – Departamentin për Çështje Administrative lidhur me regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga ajo shkresat e plota të lëndës.
9. Më 8 shtator 2014, Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative dorëzoi shkresat e plota të lëndës (nr. A354/12) në Gjykatë.
10. Më 9 dhjetor 2014, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

## **Përmbledhja e fakteve**

11. Në vijim është përmbledhja e fakteve, siç janë paraqitur nga parashtruesi në kërkesën e tij dhe të evidentuara në shkresat e lëndës nr. A 354/12 të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative.
12. Më 2001, parashtruesi i kërkesës ishte punësuar si drejtor i Drejtoratit për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë në Gjykatën Komunale në Mitrovicë.
13. Më 7 prill 2007, parashtruesit të kërkesës i ishte vazhduar kontrata e punës dhe ai ishte riemëruar në pozitën e njëjtë deri më 9 mars 2008.

14. Më 11 janar 2008, Kryetari i Komunës së Mitrovicës nxori Vendimin nr. 01/49 me të cilin emëroi drejtorët e drejtorive në Komunën e Mitrovicës. Megjithatë, parashtruesi i kërkesës nuk ishte riemëruar.
15. Më 2 tetor 2008, parashtruesi i kërkesës, parashtroi ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës (në tekstin e mëtejme: KPMK-ja).
16. Më 10 shkurt 2009, KPMK-ja me Aktvendimin nr. A.02/285/2008 aprovoi ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe e obligoi Komunën e Mitrovicës: *"që në afatin prej 15 ditësh, nga dita e pranimit të këtij vendimi, ankuesit t'i mundësoj realizimin e të gjitha të drejtave nga marrëdhënia e punës në përputhje me kontratën e punës, në atë mënyrë që në pamundësi eventuale të kthimit të ankuesit në punë dhe detyrat e punës sipas kontratës së punës, atëherë në përputhje me dispozitat e nenit 11 par. 11.1 të Udhëzimit Administrativ nr. 2003/2, mbi zbatimin e Rregullores nr.2001/36, mbi Shërbyesit Civil të Kosovës, ta ricaktoj në një post tjetër në nivel dhe shkallë të njëjtë të rrogës, në përputhje me përgatitjen dhe aftësitë e tij profesionale"*.
17. Më 24 shkurt 2009, Komuna e Mitrovicës kontestoi vendimin e KPMK-së në Gjykatën Supreme të Kosovës.
18. Më 25 shtator 2009, Gjykata Supreme e Kosovës, me Aktgjykimin A. nr. 170/2009 aprovoi padinë e Komunës së Mitrovicës dhe anuloi vendimin e KPMK-së nr. A. 02/285/2008, të 10 shkurtit 2009.
19. Më 28 tetor 2010, parashtruesi i kërkesës dorëzoi kërkesën (Rasti nr. KI108/10) në Gjykatë, me të cilën kontestonte kushtetutshmërinë e aktgjykimit të lartcekur të Gjykatës Supreme të Kosovës.
20. Më 5 dhjetor 2011, Gjykata nxori Aktgjykimin në Rastin nr. KI108/10 dhe deklaroi kërkesën të pranueshme. Gjykata gjithashtu konstatoi shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, lidhur me paragrafin 1, të nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejta të Njeriut. Rrjedhimisht, Gjykata e shpalli të pavlefshëm Aktgjykimin e Gjykatës Supreme dhe e ktheu rastin për rishqyrtim në pajtim me aktgjykimin e saj.
21. Në aktgjykimin e saj, Gjykata, *inter alia*, vëren se *"... parashtruesi kurrë nuk ka marrë kopje të aktgjykimit nga Gjykata Supreme. Për më tepër, Gjykata Supreme, nëpërmjet letrës së vet të 8 tetorit 2010, nuk ia dërgoi parashtruesit kopjen e aktgjykimit dhe e udhëzoi t'i drejtohej KPMK-së dhe më pas të kërkonte kopje të aktgjykimit. Prandaj, duket që parashtruesi nuk i ka pasur në dispozicion mjetet e parashikuara juridike"*.
22. Në arsyetim, Gjykata theksoi që: *"Gjykata përsëri vëren që, në këtë rast, procedura ka filluar në Gjykatën Supreme dhe ajo ka nxjerrë vendim përfundimtar pa praninë e parashtruesit në procedurë dhe pa e njoftuar atë për vendimin që e ka nxjerrë"*.
23. Në këtë drejtim, Gjykata gjithashtu thirret në praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejta të Njeriut, ku thuhet: *"GJEDNJ më tej konsideroi që "e*

*drejta e ndërgjyqësit për qasje në gjykatë do të ishte iluzore sikur ai/ajo të mos informohej për zhvillimet në procedurë dhe vendimet e gjykatës lidhur me ankesën, posaçërisht nëse vendimet e tilla janë të natyrës së tillë sa që do ta parandalonin shqyrtimin e mëtejshëm". (Shih, Sukhorubchenko kundër Rusisë, Aktgjykimi i 10 shkurtit 2005, paragrafi 53.)".*

24. Më 17 tetor 2012, lidhur me rastin nr. KI108/10, Gjykata ishte njoftuar nga Gjykata Supreme e Kosovës që: *"... lidhur me këtë çështje, ne ju informojmë se ky rast në Gjykatën Supreme ka marrë numrin e regjistrimit A. nr. 354/12 dhe është caktuar që të punohet më..."*.
25. Më 1 janar 2013, hyri në fuqi ligji për gjykatat Nr. 03/L-199. Në pajtim me nenin 14.1 të Ligjit: *"Departamenti për Çështje Administrative i Gjykatës Themelore gjykon dhe vendos në konfliktet administrative sipas padive kundër akteve administrative përfundimtare dhe për çështjet e tjera të përcaktuara me ligj"*.
26. Më 11 korrik 2013, Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, pas shqyrtimit kryesor, ku ishte i pranishëm parashtruesi i kërkesës, nxori Aktgjykimin A. nr. 354/12 dhe refuzoi si të pabazuar padinë e Komunës së Mitrovicës.
27. Më 22 gusht 2013, Komuna e Mitrovicës parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelit të Kosovës kundër aktgjyqimit të lartcekur të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative. Parashtruesit të kërkesës nuk i ishte dorëzuar kopja e ankesës.
28. Më 4 shkurt 2014, Gjykata e Apelit e Kosovës, me Aktgjykimin AA nr. 294/2013 vendosi që: i) të aprovojë padinë e Komunës së Mitrovicës, ii) të anulojë Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A. nr. 354/12, të 11 korrikut 2013, iii), të anulojë Vendimin e KPMK-së A 02/285/2008 të 10 shkurtit 2009, dhe iv), Vendimi nr. 01/49 i Kryetarit të Komunës së Mitrovicës, i 11 janarit 2008 mbetet në fuqi.
29. Në aktgjykimin e lartcekur, Gjykata e Apelit e Kosovës, arsyetoi:

*"Kolegji i Gjykatës se Apelit, duke u nisur nga një gjendje e tillë e çështjes dhe duke e shqyrtuar vendimin e Kryetarit të Komunës së Mitrovicës, vendimin e të paditurës KPM, aktgjykimin e ankimuar të gjykatës së shkallës së parë si dhe shkresat e tjera të lëndës gjen se, vendimi i KPM-së, dhe aktgjykimi i ankimuar nuk janë të plotë, në përmbajtjen e tyre se nuk i kanë përfshirë të gjitha provat dhe argumentet e ofruara nga palët ndërgjyqëse, por janë bazuar vetëm në disa prova dhe shkresa, pa u shqyrtuar në tërësi çështja si e tillë. Gjykata e shkallës së parë po ashtu nuk i shqyrton të gjitha provat dhe thëniet nga padia ashtu siç parashihet në nenin 44 të LKA-së, duke anashkaluar faktin se në padi paditësi thirrret në ndryshimin e legjislacionit që ka përkuar me lëmin organizativ të organizimit të komunës, duke shfuqizuar të gjitha dispozitat paraprake të zgjedhjes dhe emërimit të drejtorëve deri me atëherë në cilësinë e shërbyesve civil".*

30. Më 12 mars 2014, një kopje e Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës i ishte dorëzuar parashtruesit të kërkesës.
31. Më 21 mars 2014, parashtruesi i kërkesës parashtrroi kërkesë për revizion në Gjykatën Supreme të Kosovës kundër vendimit të lartcekur të Gjykatës së Apelit të Kosovës.
32. Më 30 maj 2014, Gjykata Supreme e Kosovës, me Aktvendimin Rev. A. nr. 6/2014 refuzoi revizionin e parashtruesit të kërkesës si të pabazuar.
33. Në vendimin e lartcekur, Gjykata Supreme e Kosovës, *inter alia*, arsyetoi:

*“..., kjo Gjykatë gjeti se kundër vendimeve të formës së prerë për çështje administrative të shkallës së dytë, pala mund të parashtrrojë kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor në Gjykatën Supreme dhe prokurori publik mund të parashtrrojë kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë, që do të thotë se kundër vendimeve të formës së prerë për çështje administrative të shkallës së dytë nuk mund të paraqitet revizion, prandaj, kjo Gjykatë e refuzon revizionin e parashtruar nga Fadil Selmanaj si të papranueshëm”.*

#### **Pretendimet e parashtruesit të kërkesës**

34. Parashtruesi i kërkesës pretendon që *“...Gjykata e Apelit e Kosovës me këtë aktgjykim ka bërë të njëjtën shkelje të cilën edhe me herët e ka bërë Gjykata Supreme e Kosovës... Gjykata e Apelit të Kosovës nuk e ka njoftuar palën e interesuar Fadil Selmanin”.*
35. Parashtruesi i kërkesës pretendon që *“... Gjykata e Apelit nuk është lëshuar fare në shqyrtimin e lëndës së parastruesit të kërkesës... nuk ka marrë për bazë fare vendimin e KPMK-së, vendimet e Gjykatës Themelore në Prishtinë... duke dashur t'i ikë përgjegjësisë së plotë, Gjykata e Apelit është lëshuar me pa të drejtë vetëm në vlerësimin se kinse Rregullorja NR. 2007/30 ku ka paraparë postet e Drejtorëve si poste të emëruara politike ... dhe kinse të gjitha pozitat e drejtorëve të mëhershëm automatikisht nënkuptohen se duhet pushuar vendi i punës... edhe pse parashtruesi i kërkesës, nuk ka qenë i emëruar politik por shërbyes civil i pranuar në punë me anë të konkursit dhe i përzgjedhur në bazë të konkursit në vendin e punës me kontratë”.*
36. Për më tepër, parashtruesi i kërkesës pretendon se Gjykata e Apelit të Kosovës kishte shkelur të drejtën e tij për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, siç garantohet me nenin 31 të Kushtetutës, sepse nuk ia dha atij të drejtën për të mbrojtur rastin e tij.



## **Ligji**

### **Ligji Nr. 03/L-202 për Konflikte Administrative**

#### **Neni 24**

*Kundër vendimit të formës së prerë të gjykatës kompetente për çështje administrative të shkallës së dytë, pala mund të parashtojë Gjykatës Supreme të Kosovës kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor.*

*Kërkesa nga paragrafi 1. i këtij neni mund të parashtrohet vetëm për shkak të shkeljes të drejtës materiale ose të shkeljeve të dispozitave të procedurës, që do të mund të kishte ndikim në zgjidhjen e çështjes.*

*Mbi kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit të gjykatës vendos Gjykata Supreme e Kosovës.*

#### **Neni 55**

##### *Rishikimi*

*Pala e interesuar mund të kërkojë rishikimin e një vendimi, që ka marrë formë të prerë, kur:*

...

*personit të interesuar nuk i është dhënë mundësia për të marrë pjesë në konfliktin administrativ.*

#### **Pranueshmëria e kërkesës**

37. Në mënyrë që të jetë në gjendje të gjykojë kërkesën e parashtruesit, Gjykata duhet së pari të shqyrtojë nëse parashtruesi i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri të përcaktuara me Kushtetutë, dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.
38. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, i cili parasheh:  
*“Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.*
39. Gjykata gjithashtu i referohet nenit 47.2 të Ligjit, i cili përcakton se:  
*“Individi mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.*
40. Gjykata gjithashtu merr parasysh rregullin 36 (1) b) të Rregullores së punës i cili përcakton:

*“(1) Gjykata mund t’i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse:*

*“(b) janë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive të përcaktuara me Ligj kundër vendimit ose kundër aktgjykimit të kundërshtuar ...”.*

41. Në rastin konkret, parashtruesi i kërkesës ka parashtruar revizion në Gjykatën Supreme kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, i cili ishte refuzuar si i papranueshëm për arsye procedurale.
42. Përveç kësaj, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës i referohet rastit nr. KI108/10, duke pretenduar se *“... Gjykata e Apelit e Kosovës me këtë Aktgjykim ka bërë të njëjtën shkelje të cilën edhe me herët e ka bërë Gjykata Supreme e Kosovës... Gjykata e Apelit të Kosovës nuk e ka njoftuar palën e interesuar Fadil Selmanin”.*
43. Lidhur me rastin nr. KI108/10, kjo Gjykatë deklaroi se *“nuk ka prova që parashtruesi ka qenë i njoftuar për mundësinë e përsëritjes së procedurës në Gjykatën Supreme, apo që ka pasur mundësi të paraqitet në procedurë të re për t’i paraqitur argumentet e veta”.*
44. Gjykata vëren se përderisa në rastin nr. KI108/10, parashtruesi i kërkesës kurrë nuk ka pranuar një kopje të aktgjykimit nga Gjykata Supreme prandaj nuk kishte mundësinë për procedurë të re, në rastin në fjalë, parashtruesit të kërkesës i ishte dorëzuar kopja e Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit dhe kështu, pati mundësinë që të përdorë mjetet e parapara me Ligjin për Konflikte Administrative Nr. 03/L-202.
45. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës nuk ka përdorur mjet juridik përkatës dhe të përshtatshëm që e kishte në dispozicion dhe për këtë arsye nuk ka respektuar format e parapara me ligjin e aplikueshëm në Kosovë. Përveç kësaj, Gjykata gjithashtu vëren se parashtruesi i kërkesës nuk ka bërë çdo gjë që mund të pritej në mënyrë të arsyeshme prej tij në lidhje me shterimin e mjeteve juridike (Shih rastin *D. H. dhe të tjerët kundër Republikës Çeke*, Nr. 57325/00, GJEDNJ, Aktgjykimi i 13 nëntorit 2007, para. 116).
46. Gjykata konsideron se në mënyrë që parashtruesi i kërkesës të lirohet nga detyrimi për të shterur të gjitha mjetet juridike që janë të obligueshme për të, ai duhet të tregojë se: i) mjeti juridik në të vërtetë ishte përdorur, ii) mjeti juridik ishte i papërshtatshëm dhe joefektiv në lidhje me rastin e tij, dhe iii) se kanë ekzistuar rrethanat e veçanta për shfajësimin e parashtruesit nga kërkesa për të shterur të gjitha mjetet juridike. Nga dokumentet që gjenden në kërkesë, nuk ka asgjë që tregon se parashtruesi i kërkesës i plotëson kriteret për t’u liruar nga shterja e të gjitha mjeteve juridike në dobi të tij.
47. Për më tepër, Gjykata vëren se pas aktgjykimit të saj në rastin nr. KI108/10, është krijuar një rast i ri me dinamikën e vet dhe, në kontekstin e ri, parashtruesi i kërkesës nuk i ka shterur të gjitha mjetet juridike.
48. Arsyetimi për rregullin e shterimit të mjeteve juridike është që t’u ofrojë autoriteteve në fjalë, duke përfshirë gjykatat, mundësinë për ta parandaluar ose korrigjuar shkeljen e pretenduar të Kushtetutës. Ky rregull bazohet në

supozimin se rendi juridik i Kosovës siguron mjete efektive juridike kundër shkeljes së të drejtave kushtetuese. Ky është një aspekt i rëndësishëm i karakterit subsidiar të Kushtetutës (Shih rastin KI41/09, parashtrues *Universiteti AAB-RIINVEST SH.P.K., Prishtinë*, Aktvendim për papranueshmëri i 21 janarit 2010, dhe *mutatis mutandis*, shih rastin GJEDNJ, *Selmouni kundër Francës*, Nr. 25803/94, Vendimi i GJEDNJ-së, i 28 korrikut 1999).

49. Prandaj, parashtruesi i kërkesës, duke mos proceduar më tej me mjet juridik përkatës, siç parashihet me ligjin e aplikueshëm në Kosovë, mban përgjegjësinë që rasti i tij të deklarohet i papranueshëm, meqë do të kuptohet si heqje dorë nga e drejta për procedim të mëtejshëm për të kundërshtuar shkeljen e të drejtave kushtetuese. (Shih rastin KI16/12, parashtrues i kërkesës *Gazmend Tahiraj*, Gjykata Kushtetuese, Aktvendim për papranueshmëri, i 22 majit 2012).
50. Nga kjo rrjedh se parashtruesi i kërkesës nuk i ka shteruar të gjitha mjetet efektive të parapara me nenin 113.7 të Kushtetutës, në mënyrë që Gjykata të vazhdojë me pretendimet lidhur me kushtetutshmërinë e Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës.

### PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit dhe me rregullin 36 (1) b të Rregullores së punës, në seancën e saj të mbajtur më 9 dhjetor 2014, njëzëri

### VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese

Snezhana Botusharova

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese

Prof. dr. Enver Hasani

